



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 825/2 Prot.

Tiranë, më 07.04.2021

VENDIM

Nr. 22, datë 07.04.2021

**PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË SEKRETARIVE MËSIMORE, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË**

Mështetur në pika 3/c, pika 4/ç, të nenit 3, pika 1 e nenit 108 të ligjit nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.463, datë 16.06.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore", udhëzimit të Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2011 "Mbi zbatimin e vendimit nr.463, datë 16.06.2011..." shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2782/1 prot, datë 17.02.2021 "Mbi pagesën e mbikohës së punës", si dhe në shkresën nr.2948/4 prot , datë 12.03.2021 "Mbi miratimin e pagesës së sekretarive mësimore, në FSHMT dhe FMD" të Administratores së UMT-së, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 07.04.2021, me tri vota pro dhe 1 kundër :

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e mbipunës së kryer nga sekretaritet mësimore të dy fakulteteve FSHMT dhe FMD, të kryer gjatë procesit të regjistrimit të studentëve për vitin akademik 2020-2021.

2. Vlera e pagesës për të dy fakultetet është si më poshtë:

| | |
|-------|---|
| FSHMT | vlera 132,000 lekë, për 288, orë/pune të kryera , |
| FMD | vlera 79,992 lekë, për 192 orë/pune të kryera, |
| TOTAL | vlera 211,992 lekë, për 480 orë/pune të kryera, |

3. Fondet e nevojshme në vlerën 211,992 lekë (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nënëtdëqind e nëntëdhjetë e dy), të përballohen nga fondet e parashikuara në llogarinë 600, duke mos tejkaluar tavanin buxhetor të përlogaritur në buxhetin e viti 2021.

4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe Administratorët e Fakulteteve për marrjen e masave për të kryer pagesat për punonjësit e sekretarive të përfshirë në proces.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Florian LOTI

